



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/  
REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



KUVENDI I KOMUNËS  
01 Nr. 060/01-10138/2023  
Datë. **25.05.2023**

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e pestë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Gjakovës për vitin 2023 e mbajtur me datë **25.05.2023**, me fillim në orën **10.00**, në sallën Solemne të Pallatit të Kulturës rruga UÇK Gjakovë.

Mbledhjen e kryesoi: znj. Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës .

Në mbledhje marrin pjesë **33** anëtarë të Kuvendit të Komunës: z. Agustin Shala, znj. Albina Sadrija, znj. Teuta Pallaska Milla, z. Nik Hiseni, z. Valon Pnishi, z. Shpend Bajrami, z. Him Zeqa, znj. Ermira Mehmeti, znj. Albulena Zuka, z. Besim Kadrija, z. Hekuran Hoxha, z. Ngadhnjim Dana, znj. Mimoza Shala, z. Mustafa Domi, z. Ledian Rexha, znj. Diana Qarkaxhija, znj. Shqipe Fejza, z. Ali Tafarshiku, z. Agon Dobruna, z. Kreshnik Alijaj, z. Bashkim Gashaj, z. Liridon Dula, znj. Lirianda Dahsyla, z. Teki Shala, , znj. Saranda Hoda, znj. Besarta Lekaj, z. Besim Ndau, z. Ardian Nushi, znj. Lerena Kameraj, znj. Krenare Bushaj, z. Fazli Hoxha.

**Mungon:** z. Ermal Kusari, z. Nexhdet Morina me arsyen.

**Të pranishëm të tjerë:** Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, Nënkyetari i Komunës së Gjakovës z. Flamur Fetahaj, Drejtori të Drejtive Komunale, përfaqësues të Mediave të OJQ-ve, të OSBE, qytetarë të Komunës së Gjakovës, zyrtarët për informim, zyrtarë të tjerë Komunal.

**Kryesuesja:** I nderuar Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, nënkyetar i Komunës, z. Flamur Fetahaj, Të nderuar anëtarë të pranishëm të Kuvendit të Komunës, Të nderuar Drejtore të Drejtive Komunale, përfaqësues të Mediave, të OSBE, Zyrtar Komunal, të nderuar të pranishëm.

Sot e kemi mbledhjen e pestë për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në këtë mbledhje janë 33 anëtarë, z. Ermal Kusari dhe z. Nexhdet Morina kanë njoftuar që nuk munden me marr pjesë në mbledhje, andaj meqenëse ekziston Kuorumi po fillojmë me mbledhjen.

Rendin e ditës me ftesën dhe materialet e mbledhjes, ju kemi dërguar me kohë.

A ka dikush ndonjë propozim sa i përket rendit të ditës.

E qes në Votim Miratimin e Rendit të Ditës sipas Ftesës që e keni marrë. **Kush Është: Pro, Kundër, Abstenim.**

**Nga anëtarët e pranishëm të Kuvendi të komunës unanimisht u votuan pro.** Pas votimit te bërë u miratua ky :

## RENDI I DITËS

1. Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **26.04.2023**.
2. Pjetje për ekzekutivin nga anëtarët e Kuvendit.
3. Informatë mbi përgatitjet ndaj emergjencave në Komunën e Gjakovës.
4. Informatë mbi shfrytëzimin e Hapësirave Publike 2023.
5. Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen verore të rrugëve në Komunën e Gjakovës.
6. Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit rreth lejeve të ndërtimit në Komunën e Gjakovës për periudhën një vjeçare.
7. Të Ndryshme.

**1. Pika e parë e rendit të ditës:** Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **26.04.2023**.

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Shqyrtimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me datë **26.04.2023**. kush është: **Pro, Kundër, Abstenim.**

Nga anëtarët e pranishëm unanimisht u miratua procesverbali i mbledhjes së mbajtur me datë **26.04.2023**.

**2. Pika e dytë e rendit të ditës:** Pjetje për Ekzekutivin nga anëtarët e Kuvendit.

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi Pjetje për ekzekutivin, E hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj. Diana Qarkaxhija:** Një prej pyetjeve të mijë të mëhershme është rruga Martinët Dinaj tek pika e zezë e cila është kërkesë e banorëve të atij komuniteti, një pjesë tjetër që është me rëndësi është sinjalizimi horizontal i cili po i mungon qytetit tonë si dhe semaforët te rruga Yll Morina pjesa për këmbësoret nuk punon pasi që kjo pjesë frekuentohet shumë nga fëmijët e të dy shkollave që janë afër po ashtu tek kjo rrugë kërkojë që të ketë policë tek hyrje daljet të cilët do të kontribuojnë në mirëmbajtjen e rregullit dhe të sigurisë të atyre fëmijëve dhe prape te rruga Yll Morina parkingu është shndërruar ne parking e gjithë oaza e gjelbëruar në krahun e shkollës ku dikur kanë qenë disa rrethoja të vogla të cilat e kanë pengu që të lëvizin makinat ndërsa në kohët e fundit gjitha veturat parkohen në atë oazën e gjelbër.

**znj. Besarta Lekaj:** Pyetja ime është rreth rrugëve prerja e tyre në mes rruga Mark Malota është shumë e dëmtuar po ashtu edhe rrugët në qytet janë shumë të dëmtuara prej prerjeve, gropave po ashtu e kam edhe një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike Ura në Trakaniq është e dëmtuar në të dy anët në ndërkohë edhe çdo reshje shiu e rëndon edhe më shumë gjendjen, kërkojë që të merrni ndonjë veprim.

**z. Ali Tafarshiku:** Shqetësimi im është për mënyrën se si po realizohet dhe koha e zgjatur e punimeve në rrugëdalje për Pejë pikërisht shqetësimin e banorëve të rrugës Bardhyl Qaushi për dëmin që po ju shkaktohet qytetarëve të Komunës së Gjakovës si dhe mos koordinimin me institucionet tjera gjegjëse që kanë për qëllim infrastrukturën nëntokësore, konkretisht fjala është për aksin që ka përfunduar shtresa e parë e asfaltit ku konkretisht javën e kaluar është zgjedh operatori për shtrirjen e gypave nëntokësor nga KRU Gjakova dhe sipas informatave gjithë pjesa e trotuarit që sapo është përfunduar do të prishet për shkak të

shtrirjes së këtyre gypave. Një pyetje tjetër ka të bëjë me sheshin Marin Barleti kam kërkuar që sa kohë që të përfshihet në buxhet po ndërtimi i asaj pjese po mendoj që është domosdoshmëri për gjithë qytetarët pasi që mund të shfrytëzohet si hapësirë rekreative. Pyetja tjetër ka të bëjë me rëndësinë që po ia kushtojmë kur po na dalin pamjet tmerruese të muzeut të muzikës në Tabhane ku jam pjesë e këtij komisioni por komisioni nuk është ftuar ende për dhënien në shfrytëzim të cilën e keni votuar për me e jap në shfrytëzim por gjendja është e njëjtë, nga kush duhet të presim thirrje për hapjen e procedurave për dhënien në shfrytëzim të Tabhanes të paktën ti përpilojmë kriteret e dhënies por nëse është kthyer vendimi nga MAPL i jashtëligjshëm duhet të na informoni, kanë kaluar disa muaj por ne nuk kemi informatë as ne si anëtarë të komisionit. Një çështje tjetër ne pjesën e vjetër të qytetit në Qarshinë e vjetër në afërsi të qendrës inovative është një objekt i cili është i djegur që nga lufta e fundit dhe ende ka mbet në gjendjen e njëjtë, kjo ndoshta për Drejtorin Gjeodezisë, më tepër më interesoj çështja e pronësisë, një pjesë e komunitetit kanë shfaqur idenë qe ky objekt të shndërrohet në muze të luftës së fundit kështu që kërkojë që të marrim informatë lidhur me pronësinë e këtij objekti.

**z. Agustin Shala:** Pyetja ime është që afër dy vite e kërkojë por deri më sot asnjëherë nuk ka gjet zgjidhje bëhet fjalë për transportin e nxënësve në fshatin Kushavec dhe në pjesën e fshatit Smaq 1, kërkojë që të bëhet kjo zgjidhje për këta nxënës sepse është shumë shqetësuese. Pyetja e dytë ka të bëjë me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik ka të bëjë me urën Tibetjane pasi që nuk mbikëqyret nga askush dhe kërkojë që të merret ndonjë masë dhe me evitu atë pjesë të rrezikut që mund të ndodhë.

**z. Agon Dobruna:** Pyetja ime është për qendrën e qytetit pikërisht për semaforët që nuk punojnë dhe në pjesën e djathtë pasi që krejt kohën ka ndërhyrje dhe më intereson të di se a janë në kuadër të lejeve dhe në fund te qendrës një segment shumë i shkurtër po krijon kolona dhe është mirë të ndërhyjni pasi që është pasqyrë e qytetit.

**z. Teki Shala:** Kërkojë nga Kryetari sqarime se ku mbeten projektet e premtuara për semaforët në qendrën e qytetit, kanalizimi në Rugovë, si dhe mos të flasim për projektin e Urës në Rugovë por pa lënë anash edhe shumë projekte të tjera. Po ashtu pyetje tjetër ku mbeti qendra grumbulluese e inverteve ku vazhdimisht gjitha mbetjet hedhen në cep të rrugëve, lumenjve, ndotje anë e mbanë komunës e që ende vazhdohet që të mos kemi një pikë për grumbullimin e mbeturinave, ende vazhdohet me të njëtin ritëm, përkundër zotimeve tuaja sot mbeten pa u zgjidh.

**z. Ledian Rexha:** Çështjen e parë desha t'ia adresojë Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për projektin e fushave të tenisit pasi që janë bërë gati 7 vite që kanë filluar si projekt dhe ende nuk është përfunduar, pasi që Komuna jonë ka disa klube shumë të suksesshme të tenisit, ky projekt ka filluar në vitin 2016, kur pritet të përfundohet dhe sa është shuma për tu përfunduar ky projekt dhe a keni menduar projekte alternative për ndërtimin e fushave tjera nëpër oborre të shkollave pasi qe ka shumë hapësira në shkolla për ndërtimin e fushave tjera. Pyetja e dytë është për Kryetarin nga banorët e objektit me dy hyrje tek pensionerët duke pasur parasysh që banorët e këtij objekti kanë krijuar shoqatën e objektit të pensionerëve për renovimin e tërësishëm nga fondacioni për të cilin kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi mes Komunës, shoqatës dhe fondacionit. Banorët e asaj ndërtese duan të din se pse ende nuk kanë filluar punimet në objektin e tyre pasi që ka shumë kohë që janë përzgjedhur si objekt i tillë për tu rinovuar. A do të fillojnë punimet në të ardhmen nëse jo me këtë fondacion me një fondacion tjetër nëse po atëherë duan ta din se kur mund të fillojnë pasi që si shoqate i kanë krijuar gjitha kushtet e nevojshme për fillimin e kësaj çështje.

**z. Kreshnik Alija:** Desha ta ngris një shqetësim të banorëve në rrugën Ali Ibra e cila ka filluar të rregullohet gjatë fushatës, punimet kanë ngelur që dy vite, çështja tjetër është ankesa e mësimdhënësve për kontraktimin e disa personave të pa ndërgjegjshëm çdo herë ka vonesë në zonën e Hasit nxënësit po thuaçse e humbin orën e parë për shkak të vonesës, çështja tjetër ka të bëjë me dëmtimin e rrugëve ne fshatin Dujakë dhe Novosellë pasi që askush nuk është marrë me këtë çështje.

**zpj. Shqipe Fejza:** Pyetja e parë e imja ka të bëjë me trotuaret në fshatin Bec prej shkollës në rrugën Bajram Avdyli e deri te lagjja ku banojnë komuniteti aty ka rrezikshmëri të lartë nga komunikacioni përfundimtë që e frekuentojnë shkollën çdo ditë, kam ngritur këtë shqetësim disa herë por asnjëherë skam marrë përgjigje si dhe kanalizimi në rrugën Rexhep Zeneli po ashtu në fshatin Bec për të cilën banorët thanë që projekti ka filluar në fushatë por që komuna nuk ka ndërmarrë asgjë ende. Pyetja tjetër ka të bëjë me raportet e punës të Drejtive Komunale për vitin 2022 që nuk janë të publikuara që komuna e ka përobligim publikim e tyre dhe kërkojë që këtu të na sillni nga një kopje të raporteve. Te drejtoria e Arsimit mungojnë kontaktet e shkollave sepse nuk janë të përditësuara po ashtu te drejtoria e shëndetësisë nuk janë të dhënat e QMF-VE dhe AMF-VE të sakta që do të thotë duhet të përditësohen të gjitha.

**zpj. Mimoza Shala:** Shqetësimi im është për Qarshinë e vjetër qytetarët po kërkojnë se a do të ketë fillim të punimeve këtë vit apo jo, të paktën të informohen edhe lokalet dhe bizneset dhe shtëpitë që banojnë në atë pjesë, është mirë që në këtë informatë për qytetarët të ketë data ose çështje të svaruara saktë për banorët.

**Kryetari:** Rruga Martinrët Dinaj janë bartur mjetet është e buxhetuar dhe do të përfundojë këtë vit, ky projekt është zgjatur për shkak se kemi menduar që janë të përfunduara kanalizimet nëse në atë lagje nuk ka grapa skeptike, mirëpo kur kemi nis të punojmë në këtë rrugë kemi parë problemet me kanalizime dhe së shpejti do të përfundojë sepse është buxetuar, ndërsa tek sinjalizimi horizontal ka pengesa për shkak të punimeve sepse në ato raste sinjalizimin e bëjnë kompanitë, ne pjesët e tjera të qytetit kemi dëmtimë të shtyllave e di që kemi probleme, kemi pas vonesa edhe me kontrata por së shpejti do të rregullohen, semaforët tek Yll Morina dhe në qendër të qytetit kemi kontraktuar kompani për semaforët në vitin 2022, çmimet për një set të semaforëve në atë kohë sipas paramasave që i bëjnë ekspertët dhe janë vendos kanë qenë në vlerat 30-35 mijë euro, janë fituar kontratat ndërsa e dini që ka ndodh ngritja e çmimeve dhe sot për një set të semaforëve çmimi është diku 60.000 euro, kompania nuk ka qenë përgjegjëse dhe e kemi shkëputur kontratën. Te semaforët në qendër e kemi shkëputur kontratën mirëpo e kemi futur si paramsë me kontratën e rehabilitimit të qendrës së qytetit rruga UQK dhe rruga Nenë Tereza deri të udhëkryqi me rrugën Beqir Kastrati që do të thotë kjo pjesë do të rinovalitet dhe kemi futur si paramasë edhe semaforët e rinj me atë renovimin që do të ndodhë sivjet. Policët tek shkolla duhet me ju drejtuar policisë sepse nuk japid urdhra ndërsa policia ka hierarki nacional, tek parkingjet komuna ka pas kontratë të lidhur për rregullimin e parkingjeve në bllok të ri, rrëth shkollës Yll Morina dhe në disa pjesë të tjera por operatori i ka ndal punët dhe nuk e ka kryer punën e kemi shkëputur kontratën dhe e kemi dërguar në gjykatë, ndërsa tanë duhet me e zgjedh operatorin e ri, për shkak të ngritjes së çmimeve në vitin 2022 na kanë shkaktuar probleme dhe operatorët kanë refuzuar me punu.

Dëmtimi i rrugëve, prerja e rrugëve është një shqetësim i madh dhe po bëj thirrje tek operatorët që të gjunjë zgjidhje, tek ura në Trakaniq disa herë e kemi rregulluar edhe pse ajo urë nuk është e parapamë për traktor të ngarkuar, është një urë që e kanë ndërtuar KFOR dhe ka mbet në atë format.

Dalja për Pejë ka filluar në vjeshtën e vitit të kaluar për shkak të procedurave të prokurimit, projekti ka qenë 2 vjeçar në fazën e parë që nënkuption zgjerimin e rrugës dhe trotuaret prej gjykatës deri të komodita te ish Emin Duraku ndërsa fazë e dytë e cila është prokuruar tash nënkuption këtë vit shtresën e dytë të asfaltit ndriçmin, gjelberimin, sinjalizimin që do të thotë në fazën e parë dhe të dytë të këtë viti duhet me përfundu komplet ajo rrugë, punimet në shtrirjen e rrjetit të kanalizimeve nuk i kryen komuna, gypat e ujësjellësit do të ndërrohen prej gjykatës gypat e ujit dhe të kanalizimit, nuk e kemi ditur kur K.R.U Gjakova mundet me e kry ujësjellësin në atë segment për shkak se ata e prokurojin nëse shkon në OSHP mundet me ndodh deri vitin tjetër që nuk e ndërrojin, un kam arrë vendim që me e shtru trotuarin me shtresën e parë të asfaltit edhe me kubëza një shtresë nëse kompania nis me punu ata punojnë sipas kushteve të komunës gjithmonë e hapin kanalin e vendosin gypin i kryejnë kyqjet dhe e kthejnë në gjendje paraprake rrugën, po shpresoj që K.R.U Gjakova nuk ka me pas probleme në procedura dhe përfundon. Sivjet përfundon rruga dhe prapë tek shpronësimet e di që ka pas shumë çështje për 50 vjet njerëzit kanë ndërtuar dhe askush nuk ka mundur ti ndalë, shpronësimet veç kanë nis me u realizu vlerën e pronave e pronave nuk e përcakton Komuna, vlerën e përcakton departamenti i specializuar i Ministrisë së Financave, Komuna e Gjakovës është e obliguar me i pagu mjetet në bazë të atij vlerësimi, qytetarët kanë të drejtë të shkijnë në gjykatë, nëse gjykata vendos me

u rrit çmimi i shpronësimit Komuna obligohet me pagu pjesën shtesë të çmimeve. Ne kemi filluar të bëjmë pagesat për vlerën qe e kemi sot, ën momentin që kryhen këto pagesa pronat dalin në emër të Komunës dhe Komuna i nis rrënimet. Kur aprovohet buxheti nuk vijnë të gjitha mjetet e aprovuara në konto të Komunës eshtë rrjedha e parasë, taksat mblidhen çdo muaj dhe mjetet që duhet me i pasë në Qershori nuk janë në Mars, mjetet vijnë sa referohen taksat, deri më 20 korrik sipas shifrave që i kemi ne i paguajmë diku 70 % të të gjitha pronave që shpronëson në rrugën dalja për Pejë, pjesa tjetër duhet të presin deri në shtator edhe pse mjetet janë të buxhetuara. Në momentin që do të rregullohet rruga tjetër menjëherë do të nisim me rrënimet. MAPL dy muaj më vonë e ka kthyer jo të ligjshëm vendimin e asamblesë komunale për Tabhanen me arsyetimin se kjo pronë nuk ka qenë në listën e pronave për dhënien në shfrytëzim, Komuna eshtë e obliguar me e publiku listën e pronave për dhënien në shfrytëzim por Komuna në atë listë nuk i qet pronat të cilat i ka dhënë në shfrytëzim, në momentin kur e kemi publikuar listën për vitin 2023 ajo prnë ka qenë veqse në shfrytëzim kjo eshtë arsyja pse nuk eshtë në këtë listë, ndërkohë eshtë shkëputur kontrata me personat që e kanë pas dhe normale që nuk eshtë në listë, ne ju kemi drejtuar MAPL me shkresë zyrtare që e kemi shkëputur kontratën për një pronë të dhanë në shfrytëzim dhe që do ta japim edhe një herë para disa dite e kanë kthyer shkresën ku thuhet se nuk e keni pas në listë për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale ju kemi drejtuar prape MAPL dhe duhet ta zgjidhim këtë çështje administrativisht. Qyteti i vjetër eshtë pronë e shoqatës së zejtarëve në kadastër figuren si i tillë, për me investu vet kemi ngecje mirëpo kemi një marrëveshje ndërkufitar për restaurimin e këtij objekti, me Lezhën e kemi marrëveshjen për me u restauru ky objekt i cili nuk eshtë pronë e komunës e as pronë private, eshtë pronë e një shoqate, nuk e di qysh zgjidhet çështja e pronësisë sepse shoqata ka ekzistuar dikur, sipas të gjitha gjasave sipas asaj marrëveshje duhet me u kryer punët.

Transportin e nxënësve Smaq - Kushavec duhet me zgjidhë, po kemi probleme, insistimi im do të jetë në stacionin e autobusëve me e rregullu trafikun urban dhe bartjen e nxënësve, tek ura Tibetjane kemi provuar me e dhënë në shfrytëzim pronën sepse eshtë pronë e komunës së Gjakovës, kemi pas problem për dhënie në shfrytëzim për shkak të pronësisë së tokës e cila eshtë në të majtë dhe në të djathtë, kemi provuar me e dhënë me memorandum mirëkuptimi me disa OJQ që merren me sporte të tilla por kemi ngushticë ligjore se si do ta japim në shfrytëzim.

Do të rinovalohet komplet qendra e qytetit dhe semaforët duhet të hyjnë komplet në paramsë të rregullimit për shkak të shkëputjes së kontratës, Hotel Pashtriku ka marrë leje prej urbanizmit formati nuk do të ndërrohet por fasada po. Në emër të qytetarëve kam më së shumti të drejtë me fol për shkak të numrave.

Për Deponinë inerte disa herë jemi munduar me gjete lokale por na eshtë kthyer negative sepse Ministria e mjedisit i shen ujerat nëntokësor se si ndoten, jemi duke u munduar me gjet zgjidhje dhe shpresoj që së shpejti do të gjejmë një zgjidhje.

Fushat e tenisit duhet me u kry këtë vit i kemi buxhetuar komplet prej Komunës eshtë në proces të prokurimit nëse nuk ka ankesa që na shtyjnë përtej viti buxhetor.

Renovimi i objekteve përfshi marrëveshja ka qenë që 30 % e vlerës me i pagu Komuna ndërsa 60 % MCC dhe 10 % banorët, pasi që janë kryer punimet banorët kanë refuzuar për ti kryer pagesat, do të provojmë të hecim më tutje por ka kosto të lartë.

Tek rruga Ali Ibra punimet nuk kanë filluar gjatë fushatës, memorandumi ka qenë i vitit 2020 me Ministrinë e Infrastrukturës ka qenë e prokuruar por kompania nuk ka qenë përgjegjëse dhe kontrata eshtë para shkëputjes.

Jemi duke punuar edhe në sheshe dhe në trotuare do të kemi kontrata të reja për hapësirat publike në të cilat do të hyjnë edhe trotuaret në Bec, sepse kemi kryer në disa fshatra. Tek kanalizimet qeveria ka treguar që Komunat nuk bënë me investu në kanalizime për shkak se nuk janë aset i Komunës janë aset i ndërmarrjes publike që do të thotë duhet të investojë K.R.U Gjakova në raste në memorandum me Komunën.

Raportet e punës nuk e kam ditur që nuk janë të publikuara por që ti sjellim sot eshtë problem për administratën. Qarshija e vjetër këtë vit do ta buxhetojmë për vitin tjetër për me u kry.

Këtë vit kryhet rruga Dërgut Vokshi deri te Krena duhet të ndahen kanalizimet, vitin tjetër kryhet rruga kryesore Sylejman Hadum Aga dhe Ismail Qemajli si dhe punët publike në qytet të vjetër këtë vit do të përfundojnë.

Arsyeja që ne rrugën Beqir Kastrati nuk është duke u punuar për shkak se në atë rrugë kanë me u ndrru gypi i kanalizimit dhe kolektori kryesor që kalon përmes banesave që vien mbrapa Pallatit të Kulturës. Këto punime siç e dini kryhen nga K.R.U Gjakova dhe ne jemi të detyruar të presim deri sa ata ti përfundojnë. Lidhur me rrugën Dërgut Vokshi siç e dini është miratu plani zhvillimor dhe Komuna është në procedurën e prokurimit për rregullimin e asaj rruge me asfalt sipas planit po ashtu në bazë te planit do të bëhet shpërthimi i rrugës tek QKMF.

**z. Shkumbin Kastrati:** Për Urën në Trakaniq jemi të informuar për situatën e cila është në gjendje të rezikshme operatori ekonomik është i informuar dhe së shpejti do të intervenohet.

Kontrata e shënjëzimit vertikal dhe horizontal është nënshkruar në nëntor dhe është shkëputur kontrata para dy muajve, jemi në procedurë të hapjes se tenderit të ri.

**Kryesuesja:** Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të myllur diskutimin për këtë pikë.

**3. Pika e tretë e rendit të ditës:** Informatë mbi përgatitjet ndaj emergjencave në Komunën e Gjakovës.

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi, Shqyrtimi i Informatës mbi përgatitjet ndaj emergjencave në Komunën e Gjakovës, prezentë e kemi Drejtoren e Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim z. **Haxhi Sejdiu** që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Haxhi Sejdiu:** Misioni i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim është që mbrojë njerëzit, pronën dhe ambientin e komunës së Gjakovës nga fatkeqësitet natyrore dhe fenomenet tjera kërcënuese. Prioritet parësor është parandalimi apo zgogëlimi i humbjes së jetërave të njerëzve, të mirave materiale, mbrojtjen e pronës, infrastrukturës dhe peisazhit natyror, përmes planifikimit, gatishmërisë dhe reagimit emergjentë, si dhe kthimit në normalitet pas fatkeqësisë.

Në realizimin e këtyre objektivave kjo Drejtori detyrat dhe përgjegjësitë e saj i realizon në koordinim dhe bashkëpunim me mekanizmat institucional të paraparë për reagim në situata emergjente, si: Shtabi Komunal për Emergjencë, Policia e Kosovës, Forcat e Sigurisë së Kosovës dhe KFOR-i, Agjencia e Menaxhimit Emergjent/MPB, Shërbimi Zjarrfikës, Institucionet e kujdesit parësor dhe dytësor shëndetësor në komunë, Kompanitë publike si: HS “Radoniqi”, KRM “Çabrati”, KEDS, Operatorët ekonomik për intervenime emergjente dhe operatorët tjerë kontraktues, Kryqi i Kuq i Kosovës – Dega në Gjakovë, dhe OJQ që veprojnë. Pasqyra e përgjithshme emergjente në territorin e komunës së Gjakovës gjatë vitit 2022 dhe tremujorit të parë të këtij viti vlerësohet të jetë stabile, përkundër faktit se territori i saj kohë pas kohe është ballafaquar me disa fenomene natyrore të cilat kanë detyruar Drejtorenë të ndërmerrë masa të mobilizimit të kapaciteteve njerëzore e teknike për reagim emergjent. Vlen për tu theksuar se nga të gjitha fenomenet natyrore më së shpeshti jemi përballur me vërshimet, zjarret, erërat e forta dhe rrëshqitjet e tokës. Sa i përket vërshimeve, situatë më serioze kemi pas në periudhën Shtator-Nëntor/2023, sidomos më problematike kanë qenë vërshimet e natyrës urbane, të objekteve të biznesit dhe sipërfaqeve bujqësore. Marrë në përgjithësi situata me zjarret gjatë vitit 2022 dhe tremujorit të pare të këtij viti ka qenë më e qetë, krahasuar me vitet e kaluara. Përndryshe, zjarret në amvisëri, zjarret aksidentale teknologjike dhe në subjekte afariste kanë qenë në nivelet e viteve të mëparshme, ku përvçe humbjeve materiale është regjistruar 1 humbje jete (në ndërtësë kolektive).

Sipas planifikimit buxhetor për vitin 2023, nga pozicioni i investimeve kapitale kjo Drejtori ka planifikuar furnizimin me një autocisternë zjarrfikëse me kapacitetet 8000 litra/ujë dhe të një automjet tereni për nevoja komanduese në zona të thella malore. Këto dy furnizime tashmë janë tenderuar, për autocisternë veç është lidhë kontrata mes Komunës së Gjakovës dhe Operatorit të përzgjedhur ekonomik. Për shkak të ndryshimeve klimatike dhe shpeshtimit të reshjeve atmosferike, disa pjesë të territorit të komunës po ballafaqohen me fenomenin e rrëshqitjeve të tokës, me ç ‘rast kemi dëmtimë të objekteve të banimit, të infrastrukturës publike, erozionit dhe degradimit të shtretërve të lumenjve etj. Në bazë të vlerësimit të kësaj Drejtorie, trendi i rrëshqitjeve të tokës është rritje e sipër, kështu që duhet të rritet vëmendja institucionale ndaj kësaj dukuri natyrore, parandalimi i së cilës mund të bëhet vetëm me planifikim të mirëfilltë, qoftë me

ngritjen e mureve mbrojtëse (për objekte banimi dhe infrastrukturën publike), me rregullimin e shtretërve të lumenjve, krijimin e kaskadave në brigjet e thepisura si dhe mbëltimin e drunjtëve në terrene të hapëta të ceneseshme nga fenomeni i rrëshqitjeve të tokës.

Qendra Komunale të Thirrjeve Emergjente-112 e cila vepron si njësi në kuadër të kësaj Drejtorie është plotësuar edhe me 4 zyrtar për telefoni, dhe me përbërjen e saj aktualisht i plotëson kriteret që të veproj si Qendër Operative Rajonale-112 në kuadër të Sistemit Unik të Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (SUAKE-112) me operim 24/7. Përndryshe, gjatë vitit paraprak në këtë Qendër janë pranuar gjithsejtë 25.079 thirrje dhe janë menaxhuar 680 raste me strukturat reaguese dhe shërbyese si: Zjarrfikësit, Policinë e Kosovës, FSK, KFOR, Kryqin e Kuq, KRU Gjakova, KEDS, KRM "Çabrat", OJQ ,etj.

Nga Janari i vitit 2022 e deri në muajin Prill të këtij viti përmes operatorit ekonomik janë realizuar 23 intervenime emergjente në tërë territorin e komunës. Kryesish kanë qenë ndërhyrje emergjente në kohë reale për parandalimin apo zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitet e shkaktuara.

Gjatë kësaj periudhe informuese, territori i komunës është ballafaquar edhe nga erërat e forta, por për dallim nga rajonet tjera të Kosovës, dëmet nga kjo fatkeqësi natyrore tek ne janë relativisht të vogla, pasi bëhet fjalë vetëm për disa raste të izoluara.

**Kryesuesja:** E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Ali Tafashiku:** Për pjesën e epërme të lumit Krena një segment që fatkeqësish sa herë ka pasur reshje të intensitetit më të lartë banorët për rrëth janë dëmtuar disa herë, a e keni arritur që këtë vit ta buxhetoni këtë pjesë për realizimin e këtij projekti ndërsa pyetja e dytë është prape për tek lumi Krena pjesa e poshtme prej urës Taliqit e deri te Spitali dhe pyetja e tretë është ndërhyrja e pjesës së lumit tek ura për në shkukëz a do të vazhdojë investimi në atë pjesë.

**znj. Shqipe Fejza:** Të falënderoj për raportin Drejtor por tek pjesa e vërvshimeve në muajin shtator dhe nëntor 2022 në raport shoh pasqyrën se sa ekonomi familjare, subjektet afariste, kulturat bujqësore, janë prekur nga vërvshimet dhe kërkjojë që ta kemi listën e këtyre që janë të prekur nga vërvshimet dhe më intereson të dijë se çfarë keni planifikuar në buxhetin e vitit 2023 përrëshqitjen e tokës në Komunën tonë ndërsa në Janar të vitit 2022 në raport thuhet se janë realizuar 23 intervenime emergjente a mund të dijmë saktë se ku kanë ndodhë këto intervenime dhe a mund të kemi listën e ekonomive familjare, subjekteve afariste që janë subvencionuar nga qeveria, sa zyrtarë të telefonisë i ka gjithsej qendra komunale e thirrjeve emergjente.

**z. Him Zeqa:** I nderuar drejtor faleminderit për raportin, e kam një kërkesë që gjatë intervenimeve a ka mundësi me u vendos hidranta në çdo anë sepse shtrirja e ujësjellësit është po thuajse në tërë territorin e Komunës së Gjakovës por hidranta ka shumë pak.

**Kryetari:** Te lumi Krena dhe te rruga Skender Shehu e cila vërvshohet sa here të ka reshje më të mëdha, vazhdimi i punimeve tek lumi Krena prej ku ka mbet tek rruga Yllka Domi deri tek tulltorja është kryer projekti dhe është ndarë buxheti ajo pjesë e rrugës është projektuar me u ngrit ura dhe me u zgjeru, tek Ereniku është pastruar një pjesë por projekti total është kështu jemi duke punuar në lumin Llukac i cili duhet me u punu në zonën urbane deri në Erenik, lumi Krena vitin e ardhshëm vazhdon prej urës së Taliqit e deri në Erenik dhe pjesa e Erenikut në mes të dy lumenjve do të lidhet me shëtitore dhe me parqet komplet. Në projekt e rrugës së re që pjesa fizike ka mbaru në rrugën Bujar Roka prej urës së Raqës e deri te ura e Tabakut parashihet trotuari me gjelbërim ndërsa prej urës së Raqës në anën e majtë e kemi një zone e cila është e parapanë komplet me gjelbërim e cila shkon deri tek lumi Llukac që do të thotë pjesa prej urës së Raqës deri te ura e Tabakut është e projektuar dhe e kontraktuar ndërsa pjesa prej urës së Raqës deri te lumi Erenik nuk është e projektuar por është me plan zhvillimor komunal e parapanë me qenë zonë e gjelbër rekreative. Ndërsa për listën e personave do ta keni pasi që është dokument publik dhe rënia e web faqes do të rregullohet shpejtë pasi që nuk është problem vetëm i Komunës së Gjakovës sepse mbahen në nivel nacional web site. Te rrëshqitjet e dheut dhe fatkeqësish duhet të ju them që asnjë komunë nuk parashev

fonde pér emergjenga arsyea eshtë që emergjencat nuk parashihen se kur do tē ndodhin dhe nëse i parashohin mjetet dhe nuk ndodh komunave ju rrënohen shpenzueshmëria. Tek hidrantat një projekt që e kemi nuk e di kur e realizojmë eshtë që uji i ujites prej kompanisë Radoniqi me e sjell një gyp deri në qytet dhe me e përcjell, hidrantët kërkojnë edhe shtypje jo veç me e pas ujin, në qytet i kemi disa hidrantë pér këtë arsyet zjarrfikësit kanë cisterna, ne mund ti parashohim por eshtë operacion që ka kosto tē lartë.

**Kryesuesja:** Meqenëse nuk ka diskutime tē tjera e shpalli tē myllur diskutimin pér këtë pikë.

#### 4.Pika e katërt e rendit te ditës: Informatë mbi shfrytëzimin e Hapësirave Publike 2023.

**Kryesuesja:** Pér këtë pikë tē rendit tē ditës e kemi Informatë mbi shfrytëzimin e Hapësirave Publike 2023. Prezentë e kemi Kryetarin e Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini, tē cilin e ftojë që ta merr fjalën.

**Kryetari:** Janë disa lloje tē dhënies dhe shfrytëzimit tē hapësirave publike nëpër Komuna. Kemi dhënie afatgjate, afat mesme dhe afatshkurtër si dhënie tē drejtpërdrejta, kemi dhënie në shfrytëzim tē pronave në bazë te ligjt me investime strategjike që e parashev vit pas viti vlerën e investimit se cili mundet me qenë investimi strategjik, duhet me qenë investimi së paku sa 10 % e investimeve kapitale e vtitit paraprak ky eshtë provizioni ligjor që do tē thotë këtë vit në Komunë e Gjakovës pér me u kualifikua pér me u trajtu si investim strategjik një investitor duhet me investu së paku 1.2 milion pér shkak se 12 milion kanë qenë investimet vitin e kaluar, në vitin e ardhshëm me siguri do tē jetë 1.6 milion e kështu me radhë, kemi pak raste në tē cilat janë dhënë pronat në shfrytëzim në bazë tē ligjt pér investime strategjike. Tek dhënia afatgjate kemi raste kur prona jepet me afat më tē gjatë, tek dhënia afat mesme po ashtu janë kryesisht biznese, afatshkurrat janë një vit shfrytëzim epen pér shfrytëzime sezionale ose tē përkohshme tē hapësirave publike që kanë tē bëjnë me terasat, me ndonjë pjesë tē hapësirës pér ekspozim tē mallrave. Qëllimi eshtë që tē gjitha hapësirat publike që shfrytëzohen prej operatorëve privat tē kenë kontratë tē shfrytëzimit, kemi shumë hapësira publike që shfrytëzohen pa kontratë, e kemi nis procesin edhe përmes njoftimeve edhe përmes nënshkrimit të kontratave, në dy muajt e kaluar janë nënshkruar diku 30 kontrata dhei 17 janë në shqyrtim, inspektorati dhe drejtori i inspektoratit eshtë instruktuar me shku tek operatorët ekonomik me paralajmërim jo me gjoba menjëherë dhe deri në fund tē muajit maj nuk shkojmë me gjoba, duhet me apliku pér shfrytëzimin e hapësirave publike në bazë tē tarifave që janë përcaktuar, tarifat nuk janë arbitrale pér janë në bazë tē rregullores pér taksa dhe tarifa që eshtë marrë vendimi në asamble. Sipas raportit 54 kërkesa, 27 kontrata, 13 janë aprovar pér shfrytëzimin e terreneve sportive, 10 janë refuzuar dhe 4 lëndë janë në shqyrtim. Refuzimi mund tē ndodh nëse hapësira eshtë e paraparë pér diçka tjetër ose nëse ka ndonjë plan pér zhvillim tē ndonjë projekti. Kemi interes si komunë që tē gjitha hapësirat publike që shfrytëzohen me qenë me kontratë dhe pas datës 1 qershor inspektorati do tē fillojë me shqiptimin e gjobave pér operatorët tē cilët nuk kanë bërë as kërkesë pér shfrytëzim tē pronës.

**Kryesuesja:** E Hapi Diskutimin pér këtë pikë tē rendit tē ditës.

**z. Teki Shala:** Kryetar tē falënderoj pér rapporti mirëpo në raport nuk kemi informatë se pér çfarë shfrytëzohen këto hapësira publike. Përkundër hapësirës së madhe publike që ka Komuna vetëm 27 prona shfrytëzohen kjo tregon se Komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë aktivitet tē theksuar, e tregove që prej datës 1 qershor do tē fillojnë gjobat por çka ka ndodh deri më tanë. Vitin e kaluar në mënyrë selektive i keni ndërmarrë disa hapa si në rastin në Rugovë lirimin e hapësirës publike e fatkeqësisht ai aktivitet nuk ka vazhduar edhe në hapësirat tjera k jemi dëshmitarë se hapësirat publike shfrytëzohen në krejt komunën ilegalisht, themi ilegalisht pér shkak se nuk ka kontratë, nuk paguan qiranë komunës në bazë tē rregullores mbi tarifën dhe ngarkesat kështu që kisha kërkuar që aksioni tē mos jetë selektiv dhe tē fillojë me tē gjithë ata që e shfrytëzojnë këtë hapësirë tē marrin leje ti paguajnë komunës obligimet e tyre që dalin nga këto kontrata dhe gjithashtu informatën që e keni dhënë ti shtohet edhe se këto kontrata pér çfarë qëllimi janë dhënë në shfrytëzim.

**z. Ali Tafarshiku:** Të falënderoj kryetar për raportin sinqerisht pe du me ju falenderu pasi që ka qenë kërkesë e grupit të LVV ky raport dhe e keni marrë për bazë dhe në kohë rekord e keni sjellë si rend dite. Hapësirat publike i shfrytëzojnë të gjithë qytetarët pa dallime politike, pa dallime të bindjeve tona që do të thotë janë hapësira që janë në dispozicion të të gjithëve por fatkeqësisht kryetar e keni një komision i cili nuk i trajton të gjitha kërkesat njëjtë që do të thotë nuk e ka primare rëndësinë e shfrytëzimit të hapësirës publike se sa e ka primare selektimin e kërkesave qoftë me refuzime, qoftë me rishqyrtimë dhe dalim te momenti i poletizimit unë jam i bindur se për çdo kërkesë nuk vijnë me e marr mendimin tënd personal kryetar dhe nuk besoj që për çdo kërkesë ti i fton ose i ordinon një komision që do të duhej të ishte profesionist, i pavarur mirëpo ndodh që edhe dhënien e hapësirave publike e jadin pa e llogarit pengesën që mundën të tjerëve me ju shkaktu për shembull hapësirat publike që u jepen në shfrytëzim bizneseve pjesa e trotuarit ku ka lëvizje të këmbësorëve e në anën tjetër kemi refuzim të kërkesës për shembull shfrytëzimit tek parku i qytetit që do të thotë një biznesi që vitin e kaluar Drejtori I Urbanizmit ia ka japur lejen për shfrytëzim këtë vit i mohohet ose i refuzohet e njëjtë kërkesë, operatori e ka kryer pagesën e ka rregulluar parkun që do të thotë edhe një pjesë të punës së Komunës e ka kryer ka mbjell lule e ka zbukuruar vendin mirëpo tash komisioni ia refuzon kërkesën pa jep asnjë lloj sqarimi. Në raport thuhet se shumica e kërkesave që janë refuzuar kanë të bëjnë me mos plotësimin e dokumentacionit, a ka për obligim ky komision me e mbajt një sesion informues për ato biznese. Kërkojë që të trajtohen të gjithë operatorët të barabartë.

**Kryetari:** z. Teki se për çka shfrytëzohen pronat nuk mund të dijë për të gjitha por dokumentacionet ekzistojnë dhe janë publike. Janë dhënë shumë prona, ky proces tashmë është tek terasat, tezgat, tek shfrytëzimi i hapësirave të vogla, ka shumë prona që janë në shfrytëzim e që nuk kalojnë afatin më shumë se 1 vit. Tek komisioni nuk i pyes përpos nëse komisioni më drejtohet për ndonjë paqartësi. Tek hakmarrja politike kish me qenë nëse në dhjetor të vitit 2021 Kryetari I Komunës kish marr vendim konform ligjit me i rrënu krejt anekset të cilat janë bërë pa leje në prona publike, hakmarrje kishte me qenë nëse un me plotë të drejtë pa e shkelur ligjin i kisha thënë inspektoratit me i qitë shiritat dhe me i rrënu sepse janë pa leje dhe janë jashtë kontratës për shfrytëzim të pronës. Nëse një operatori cili prej Komunës për shfrytëzim afat mesëm e ka marrë një pronë e rrit atë pronë për 250 m pa leje të Komunës dhe pastaj e kërkojnë edhe një hapësirë tjetër, nuk mundet operatori me kërku më tepër se sa është duke e shfrytëzuar sepse duhet me marrë leje për atë të cilët është duke e shfrytëzuar jashtë kontratës. I njëjti operator si dhe operatorët e tjerë duhen me bo kërkesë në Komunë për hapësirat që janë duke i shfrytëzuar e pastaj kërkesë për pronat tjera si dhe mos me bo anekse pa leje. Komisioni nuk guxon të jetë arbitrar, ka raste kur nuk mundet e në këtë rast nuk mundet sepse nuk e ka pëlqimin për pronën të cilën e shfrytëzon.

**z. Ali Tafarshiku:** Kryetar me dal këtu edhe me personalizu debatin, unë morra shembull edhe ti argumentoj shembujt, për shembull e kam një kërkesë të 6 banorëve që e kanë kërkuar hapësirën për parkimin e automjeteve të veta private për shfrytëzim 1 vit, banorë të ndërtësës kolektive, ky komision kryetar parimor ka hy dhe i ka analizuar emrat dhe se në cilat parti politike janë dhe sot ja kanë refuzuar kërkesën, e dyta tek çështja ka usurpuar ose shfrytëzuar pa letra dhe me gjithë dijeninë tënde jeni duke e lejuar atëherë çfarë kryetari jeni ju, ju publikisht e pranuat dështimin e juaj, un nuk jam as inspektor dhe as polic unë thjesht ta dhashë një shembull që një kërkesë legititime ia keni jep drejtoria e urbanizmit vitin e kaluar. Tu kisha lutur kryetar mos i personalizo un thjesht morra shembull se pse një biznesi i refuzohet e tjerëve ju lejohet.

**Ngadhnjim Dana:** Kryetari i Komunës çdo herë kërkon nga administratë që të publikohen e të njëjtat nuk publikohen asnjëherë, tjetra është që u përmendën shumë shembuj për prona por ajo çka është e pa shembullt Kryetari i Komunës thotë që e dijmë që është duke bërë dikush diçka pa leje dhe nuk ndërmerrë asnjë masë.

**Kryetari:** Është e lehtë të thuhet por ju lutem gjeni një rast dhe tregoni se çfarë nuk është publikuar atëherë je kredibil për ne dhe për qytetarët, nëse nuk qëndron sistemi në rregull atëherë nuk ka të bëjë me mos publikim. Nëse pronat komunale nuk janë publike atëherë nuk mund të jepen në shfrytëzim.

**Kryesuesja:** Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë.

**5.Pika e pestë e rendit te ditës:** Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen verore të rrugëve në Komunën e Gjakovës.

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendi të ditës e kemi Informatë mbi përgatitjet për mirëmbajtjen verore të rrugëve në Komunën e Gjakovës, prezentë e kemi Drejtorin e Drejtorisë Për Shërbime Publike z. **Nikoll Lleshi**, të cilin e ftojë që ta merr fjalën lidhur me këtë pikë të rendit të ditës .

**z. Nikoll Lleshi:** Komuna e Gjakovës, ka kontratë një vjeçare me KRM “Çabratin”, për Mirëmbajtën e auto rrugëve në Komunën e Gjakovës”.

Kompania Regionale e Mbeturinave Çabratit ka kryer mirëmbajtjen e rrugëve në gjithë territorin e komunës së Gjakovës me shërbimet e fshirjes, pastrimit dhe larjes së rrugëve, nga vitet e kaluara dhe vazhdon edhe në këtë vit.

Rrugët të cilat mirëmbahen dhe fshihen në baza ditore të rregullta mujore sipas planit operativ janë të renditura në dokumentet që ju kemi dërguar me materialet e mbledhjes . Në këtë kontratë janë të parapara edhe disa pozicione sipas nevojës që është pastruar edhe lumi krena dhe Pllatoja dhe shëtitorja e lumbit Krena si dhe ndonjë vend tjetër sipas nevojës, unë mendoj se kompania është duke e kryer punën e tyre me sukses dhe gjendja në teren është e mirë dhe kompania shihet për çdo ditë që është e angazhuar dhe është në punën.

**Kryesuesja:** E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**znj. Mimoza Shala:** Ne kemi kërkuar që në Statut të përshkruhen kompetencat dhe detyrat e drejtorive sepse edhe ne nuk po e kemi të qartë se cilës drejtori me ju drejtua. Për gjelbërimin e rrugëve a ka planifikim të bëhet gjelbërimi edhe në pjesët rurale të rrugëve.

**z. Him Zeqa:** Unë e kam një kërkesë për rrugën Meje – Junik për mirëmbajtje verore pasi që nuk është në kuadër të Ministrisë sepse asnjëherë nuk mirëmbahet kjo rrugë.

**z. Valon Pnishi:** E kam një kërkesë lidhur me fshatrat Fshaj – Ujz lagjja Pnish e Damjanit a ka mundësi që edhe kjo rrugë të mirëmbahet edhe gjatë sezonës verore sepse rruga është e ngushtë dhe e mbuluar me drunjëtë në të dy anët dhe propozojë që në të ardhmen të kemi një memorandum me ngrohtoren e qytetit që mund të riciklohen këta drunjëtë dhe të përdoren për bio masë.

**z. Teki Shala:** E falënderojmë drejtorin për raportin, ne këtë raport e kemi diskutuar edhe në KPF, kjo kontratë që është me kompaninë Qabratit për mirëmbajtjen verore të rrugëve, fjalë është për mirëmbajtje të gjelbërit, pastrimin nuk bëhet fjalë për mbushjen e gropave por vetëm për mirëmbajtjen verore të rrugëve dhe kemi kërkuar nga drejtori që të përfshihen edhe pjesët tjera kryesore për shkak se mirëmbajtje ka nevojë edhe për zona rurale e jo vetëm në qytet.

**Kryesuesja:** Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e shpalli të mbyllur diskutimin për këtë pikë .

**6.Pika e gjashtë e rendit te ditës:** Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit rrëth lejeve të ndërtimit në Komunën e Gjakovës për periudhën një vjeçare .

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendi të ditës e kemi Informatë nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit rrëth lejeve të ndërtimit në Komunën e Gjakovës për periudhën një vjeçare, prezentë e kemi Drejtorin e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të mjedisit z. **Arben Bakalli** që ta merr fjalën .

**z. Arben Bakalli:** Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Gjakovë, në shërbim të kërkesës së datës 12.05.2023, nga znj. Mimoza Shala, ku përmes të cilës është kërkuar që për mbledhjen e radhës të Kuvendit, nga DUMM të prezantohet një raport lidhur me lejet e ndërtimit për periudhën një vjeçare, duke përfshirë sa leje janë dhënë për këtë periudhë, sa leje janë dhënë pasi kanë filluar ndërtimet, dhe për sa kërkesa nuk janë dhënë lejet e ndërtimit dhe pse janë bërë kërkesat.

Në shërbim të kërkesës së parashtruar, ka bërë analizimin e të gjitha lejeve të trajtuarë për periudhën 1 (një) vjeçare nga DUMM dhe, pas verifikimit dhe analizimit të lejeve të lëshuara për këtë periudhë ju informon si në vijim: Gjatë periudhës janar — dhjetor 2022 janë lëshuar gjithsej 109 leje ndërtimore dhe nga to:

60 leje ndërtimore për kategorinë e parë (objekte me rrezikshmëri të ultë), me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim  $S=5015.87 \text{ m}^2$ .

31 leje ndërtimore për kategorinë e dytë (objekte me rrezikshmëri të mesme) me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim  $S=144.455.97 \text{ m}^2$ .

18 leje të institucioneve arsimore, fetare dhe panele solare. Gjatë periudhës Janar — Maj 2023, gjer më tanë janë lëshuar gjithsej 52 leje ndërtimore dhe nga to, 25 leje ndërtimore për kategorinë e parë (objekte me rrezikshmëri të ultë), me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim  $S=9695.1 \text{ m}^2$ .

21 leje ndërtimore për kategorinë e dytë (objekte me rrezikshmëri të mesme) me sipërfaqe totale të trajtuar për ndërtim  $S=73.511.8 \text{ m}^2$ .  
7 leje të institucioneve arsimore, fetare dhe panele solare.

DUMM-Gjakovë, për sa i përket pyetjes së parashtruar se sa leje janë dhënë pasi kanë filluar ndërtimet, meqenëse pyetja nuk ka qenë e specifikuar në mënyrë të qartë, ju informojmë se bazuar në legjislacionin në fuqi, dhënia e lejeve ndërtimore përpos tjerash është paraparë, pra është e mundur të lëshohet sipas kërkesave të investorëve dhe sipas principit të ndarjes nëpër fazat, për shkak të pamundësisë së pagesës në tërësi apo dhe për shkaqe të tjera, ku gjatë kësaj periudhe disa blloqe banesore janë trajtuar sipas këtij principi. DUMM-Gjakovë, për sa i përket pyetjes së parashtruar se për sa kërkesa nuk janë dhënë lejet e ndërtimit dhe pse janë bërë kërkesat, ju informojmë se për vitin 2022 (periudha janar — dhjetor) gjithsej janë refuzuar 20 kërkesa për kushte si dhe për leje ndërtimore, ndërsa për vitin 2023 (periudha janar — maj) janë refuzuar gjithsej 25 kërkesa për kushte si dhe për leje ndërtimore, të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme, kryesisht kërkesa për tejkalim ose në kundërshtim me dokumentet hapësinore në fuqi

**Kryesuesja:** E Hapi Diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

**z. Mimoza Shala:** Ky rapport është shumë i mangët sidooftë kërkoj një shpjegim për periudhën Janar Dhjetor 2022 tek lejet ndërtimore te kategorisë së parë që janë 60 leje me rrezikshmëri të ulët ndërsa kur dalim në vitin 2023 gjatë periudhës Janar-Maj e shohim që janë 25 leje që janë dhënë deri më tanë nëse por nëse e shohim në sipërfaqe për 60 leje brenda 1 viti janë 5015 m ndërsa për 25 leje janë 9695 m dyfishi i sipërfaqes së ndërtimit a mund të ma shpjegoni si ndodh kjo, un kam pyetur sa blloqe janë e jo veç disa si është e shkruar në rapport a mund ta kem edhe këtë informatë që janë japur lejet pasi që kanë filluar ndërtimet.

**z. Agon Dobruna:** Në të gjithë zonën e qytetit, në bllokun e ri, lagjen Gec i shohim ndërtimet në cep të sipërfaqes a e merrni për bazë Drejtoria e juaj pjesën e gjelbër, pjesën e parkimeve dhe duhet të kemi vizion dhe të respektohet Plani Urbanistik.

**Kryetari:** Të gjitha lejet e ndërtimit janë të publikuara dhe të gjithë kanë qasje por plani me të cilin punojmë ne është i bërë në vitin 2005 me përjashtim të Rezinës që është bërë në vitin 2011. Nëse ekziston një plan për Lagjen Gec, për rrugën Ganimete Tërbeshi dhe çdo kush mund të kërkojë lejen në bazë të atij lani dhe nëse Drejtoria e Urbanizmit e refuzon kërkesën për leje atëherë e ka shkelur ligjin.

**z. Ali Tafarshiku:** Kjo temë është e rëndësishme për qytetarët e Komunës së Gjakovës, po i përmendi disa prej koncepteve që në vazhdimësi është marrë si marketingu ose fushatë që opozita është kundër

operatorëve ekonomik dhe nuk ka opozita vizion sepse nuk din se çfarë është ndërtimi. Ideja dhe vizioni shfaqen në plan, plane urbanistike të cilën e bëjnë qeveritë që shkojnë e vijnë, për atë edhe fitohen zgjedhjet, që do të thotë qytetarët së pari i besojnë vizionit dhe idesë një qeverisje. Kemi kërkuar plotësim ndryshimin e planit urbanistik Gjakova 2005 në mandatin e parë të juajin dhe nuk keni shpreh gatishmërinë për disa mundësi për të eliminuar degradimin e qytetit. Një ndërtim që ka ndodh në vitin 2009 ndërtesë kolektive e që jetojnë 20 familje e tash me ja jap në vitin 2023 një leje dikujt tjetër që i blokon totalisht dhe i detyron me i braktis banesat e tyre nuk më duket në rregull, pavarësisht në cilin plan apo rregullore jeni bazuar sepse është diferenca e viteve.

**Kryetari:** Në rrugën Yll Morina ka ekzistuar një objekt pa leje, janë ndërtuar dy objekte përpara dhe i kane bllokuar dhe shpjegimi është pasi që objekti ekzistues është objekt pa leje ndërsa objekti që është duke u ndërtuar tani është objekt sipas planit me leje. Rastet e ndërtueseve pa leje kanë rënë. Industrinë e ndërtimit nuk e shoh të keqe, e shoh shumë të mirë përderisa qëndrojmë ne plane konkrete. Hartat zonale bazohen në planin zhvillimor të cilin e kemi kaluar vitin e kaluar dhe duhet me qenë plotësisht në përputhje me të.

## 7. Pika e shtatë e rendit të ditës: Të Ndryshme.

**Kryesuesja:** Për këtë pikë të rendit të ditës e kemi të ndryshme a ka dikush ndonjë diskutim për këtë pikë.

**Kryesuesja:** Përmes postës elektronike jeni të njoftuar rreth një punëtorie një ditore me temën “ Procesi përgatitor i dëgjimeve buxhetore të planifikimit të buxhetit komunal për vitin 2024” kërkojë që të jeni prezentë pasi që është në interesin tonë.

**Kryesuesja:** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj. Mimoza Shala:** Desha të diskutojë tek të ndryshmet pikërisht për këtë ftesë, kur bëhet fjale për barazinë gjinore dëshirojë që të jem prezentë, se jo që pres që trajnimet me më vetëdijesua mu se çka është koncepti gjinor por përpjekjet gjithmonë i kam pasur në këtë Kuvend për me pas reformë dhe shpresë sidomos për vajzat e reja për me u kyç në politik bërje. Këtë organizim po e shoh të shkruar që e ka bërë Komiteti për Barazi Gjinore por nuk po e shoh askund emrin e Kryesuesit të këtij komiteti i cili ka japur shumë kontribut e kam fjalën për Ledianin sepse ai e udhëheq këtë komitet, ka zhvilluar disa takime me gjithë respektin për organizatat të cilat e mbështesin çdo herë këto qëllimet tona për përparimin e çështjeve gjinore mirëpo është bërë e tepërt sepse prej se kam hy në asamble kam kërkuar me u krijuar një komitet i tillë mirëpo qëllimi ka qenë pikërisht nga shuarja e shpresës së zyrtares e cila e udhëheq zyrën për barazi gjinore e tash ku është hapësira e njerëzve që kanë jap kontributin.

**Kryesuesja:** Meqenëse nuk ka diskutime të tjera e Shpalli të mbyllur këtë mbledhje dhe mirë u takofshim në mbledhjet e radhës.

**Mbledhja përfundoj në ora 14:30.**

**Procesmbajtës**

**Burim Bajrami**

**Arbënesha Kuqi**

**Kryesuesja e Kuvendit**